



iSIGURT.al

PLATFORMA KOMBËTARE PËR SIGURINË NË INTERNET
Linja Kombëtare për Internet në Sigurt për Fëmijët

INTERNET I SIGURT PËR FËMIJËT

RAPORTO!



**BARNAHUS
ALBANIA**

Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve
dhe të Rinjve nga Dhuna Seksuale



TELEFONI I NDIHMËS PËR FËMIJËT

Misioni dhe Vizioni

iSIGURT.al – Platforma Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri, një shërbim kombëtar i ngritur nga CRCA/ECPAT Shqipëri në vitin 2015, ka si mision të saj kryesor raportimin dhe heqjen e materialeve në internet, në rrjetet sociale dhe mediat online, që përmbajnë:

- **Dhunë seksuale ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve**
- **Bullizëm dhe dhunë ekstreme ndaj fëmijëve dhe të rinjve**
- **Gjuhën dhe krimet e urrejtjes**

Platforma synon të nxisë raportimin e faqeve të paligjshme apo me përmbajtje të papërshtatshme në internet. Ne fokusohemi në ndërgjegjësimin, edukimin dhe fuqizimin e fëmijëve, të rinjve, prindërve dhe mësuesve, institucioneve, medias, industrisë së internetit dhe publikut të gjerë, që të përdorin internetin dhe mënyrat e tjera të komunikimit teknologjik pozitivisht, të sigurtë dhe në mënyrë efektive. Platforma Kombëtare për Internetin e Sigurtë është një hapësirë e dedikuar, e cila shërben si një burim unik informimi dhe formësimi për fëmijët, prindërit dhe të gjithë profesionistët.

Linja Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet

Linja Kombëtare për Sigurinë në Internet të Fëmijëve, funksionon pranë **iSIGURT.al** dhe ka si qëllim kryesor raportimin e menjëhershëm të të gjithë incidenteve me përmbajtje të dhunës seksuale, dhunës ekstreme, bullizmit etj., që fëmijët dhe të rinjtë ndeshin gjatë përdorimit të internetit. Nga ana tjetër ajo është një hapësirë informimi për prindërit, mësuesit, profesionistët dhe këdo që punon me/për fëmijët për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe shfrytëzimi online, apo për eliminimin e gjuhës së urrejtjes.



RAPORTO!

Platforma ka dy rubrika të dedikuara RAPORTO! Ajo udhëhiqet nga standardet më të larta profesionale dhe të besueshme për publikun për të lejuar raportimin anonim dhe konfidencial të përmbajtjes së papërshtatshme dhe të paligjshme të materialeve dhe aktiviteteve të hasura në internet, në media, në programe televizive etj.

RAPORTO

Foto, video, chat apo çdo material me përmbajtje të dhunës apo ngacmimeve seksuale të fëmijëve apo adoleshentëve në internet.

RAPORTO

Gjuhë të urrejtjes (fjalime, shkrime, thirrje) apo video dhe imazhe që nxisin urrejtjen kundër fëmijëve, grave, minoriteteve, personave LGBTI, atyre me aftësi të kufizuara, besimtarëve etj.

Çfarë ndodh pas raportimit?

Një analist i iSIGURT, e merr raportimin dhe analizon ankesën e bërë nga fëmija, prindi, mësues, qytetar, profesionist apo çdo person tjetër, duke vlerësuar nëse faqja apo materiali i raportuar ka përmbajtje të dhunës seksuale ndaj fëmijëve (imazhe / video / chat etj.), dhunë ekstreme ndaj fëmijëve apo adoleshentëve, bullizimën etj.;

Ose kur ankesa ka lidhje me një material me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes apo që nxit krimet e urrejtjes online dhe në media në tërësi, në programe televizive, media online, platforma lajmesh apo rrjete sociale;

- Pas vlerësimit, nëse ankesa rezulton se ka lidhje me faktet e përmendura më sipër, atëherë analisti, në varësi të përmbajtjes, e referon atë ose tek organet e zbatimit të ligjit, ose merr masa për bllokimin e faqes apo heqjen e materialit nga interneti;
- Analistët tanë gjithashtu këshillojnë ankuesit online duke ju rekomanduar atyre hapa praktikë sesi mund të mbrohen më mirë ose duke i informuar për ndjekjen e ankesës edhe me Policinë e Shtetit apo Prokurorinë.

Dita Ndërkombëtare e Internetit të Sigurt



Dita e Internetit të Sigurt

2024 | Të Martën
6 Shkurt

www.saferinternetday.org

www.iSIGURT.al



Dita e Internetit të Sigurt (SID) organizohet çdo vit në muajin shkurt për të promovuar përdorimin e sigurt dhe pozitiv të teknologjisë dixhitale, veçanërisht midis fëmijëve dhe të rinjve. Në Shqipëri, dita organizohet nga Platforma Kombëtare për Internet të Sigurt (www.iSIGURT.al), e CRCA/ECPAT Shqipëri, që është anëtare e INHOPE dhe Insafe, organizatorë të ditës në nivel global. Në të gjithë botën, miliona njerëz bëhen së bashku për të sjellë ndryshime pozitive në internet dhe për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e sigurisë. Edhe ju mund të luani rolin tuaj në këtë drejtim!

Dita e Internetit të Sigurt synon të krijojë një internet më të sigurt dhe më të mirë, ku të gjithë jemi të fuqizuar të përdorim teknologjinë me përgjegjësi, respekt, kritikë dhe kreativitet. Fushata synon të arrijë tek fëmijët dhe të rinjtë, prindërit dhe kujdestarët, mësuesit, edukatorët dhe punonjësit socialë, industrinë e internetit dhe komunikimit, vendimmarrësit dhe politikanët etj., për të inkurajuar të gjithë që të luajnë rolin e tyre në krijimin e një mjedisi në internet sa më të mirë për këdo. Duke festuar fuqinë pozitive të internetit, sloganin e Ditës për Internet të Sigurt "Së bashku për një internet më të mirë" inkurajon të gjithë që t'i bashkohen lëvizjes, të marrin pjesë dhe të shfrytëzojnë sa më shumë potencialin e internetit për të bashkuar njerëzit.

Në Shqipëri dita organizohet që nga viti 2005. Këtë vit një sërë aktivitetesh publike të rëndësishme do të organizohen, ku mund të përmendim: Raportin Kombëtar për Internetin e Sigurt në Shqipëri, që është një publikim i përvitshëm që tregon për incidentet që raportojnë fëmijët gjatë navigimit të tyre në internet; organizimin e sesioneve ndërgjegjësuese në klasa dhe shkolla për informimin e nxënësve dhe mësuesve; hapja e fushatës kombëtare online për internet të sigurt për fëmijët.

Të bëhemi së bashku për një internet më të sigurt dhe më të mirë! Na shkruani në adresën tonë: isigurt@crca.al ose vizitoni www.isigurt.al